



Indeksi i Transparencës për Buxhetin 2008 dhe 2009

International Budget Partnership bashkëpunon me shoqërinë civile në gjithë botën për të përdorur analizën e buxhetit dhe advokimin si një mjet për të zhvilluar qeverisjen dhe për të ulur varfërinë. IKU merr pjesë dy herë si partneri për Shqipërinë në Pyetësorin e Transparencës së Buxhetit 2008 dhe 2009 si një nga organizatat civile partnere nga 85 vendet pjesëmarrëse në studim.

Qëllimi

Qëllimi i Projektit "Indeksi i Transparencës së Buxhetit" është të vlerësojë sasinë dhe llojin e informacionit në dispozicion të publikut në lidhje me dokumentat e buxhetit në Shqipëri."

Aktivitete janë kryer në dy dimensione:

Përdorimi i të gjithë mjeteve të informacionit për dokumentat kryesorë të buxhetit si:

- Fletorja Zyrtare, interneti (faqja e internetit e Ministrisë së Financave, e Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe institucioneve të tjera, bibliotekat etj).
- Intervista me punonjës të Ministrisë së Financave apo institucione të tjera për të plotësuar përgjigjet me komentet përkatëse duke ju referuar një dokumenti buxheti, një ligji apo udhëzimi përkatës. Ideja kryesore në kërkimet dhe punën e kryer nga IKU qëndron në ofrimin e një tabloje të qartë të asaj që ndodh në praktikë në lidhje me afatet kohore dhe përmbajtjen e dokumentave që i



servilen publikut dhe jo në atë që kërkohet nga ligji. Në përfundim, Shqipëria është renditur në një kategori performance të përcaktuar nga mesatarizimi i përgjigjeve të 123 pyetjeve në Pyetësorin për Transparencën e Buxhetit në lidhje me informacionin e paraqitur në 8 dokumentat kryesorë të buxhetit që të gjithë vendet duhet t'i bëjnë publike.

Rezultat e pritshme

Rezultat e pritshme nga ky projekt janë të pasqyruara në përpjekjet për rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në mënyrë që të përforcohet besimi i qytetarëve tek qeveria dhe bashkëpunimi ndërmjet dy palëve. Në çdo fazë të procesit të buxhetit, informacioni i botuar publikisht gjithashtu përcakton aftësinë e shoqërisë civile (si media, legjislacioni dhe institucionet e larta të auditit) për të influencuar, monitoruar dhe përcaktuar eficiencën e politikave qeverisëse. Faza e fundit e projektit konsistoi në planin e veprimit nga IKU për linçimin e rezultateve

të OBI 2009 për Shqipërinë nëpërmjet workshop me aktorë të interesit dhe shoqëri civile si dhe nëpërmjet publikimeve në media.

Përmbledhja për Shqipërinë dhe Pyetësori përkatës për vitin 2008 mund të gjenden duke klikuar në www.openbudgetindex.org/countryDATA/.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ International Budget Partnership

KOHËZGJATIA:

2007 - 2008 dhe 2008 – 2009

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtore Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitet e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.